

VENDIM
Nr.288, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujtitjen dhe për kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Fierit, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës Cakran-Frakull dhe lugina e Vjosës (FRK-1), që kullon një sipërfaqe 4811 ha;
b) zona e fushës së Hoxharës (FRK-II, që kullon me ngritje mekanike me hidrovor një sipërfaqe 9900 ha;

c) zona e fushës së Hoxharës (FRK-III), që kullon me ngritje mekanike me hidrovor një sipërfaqe 7200 ha;

ç) zona e fushës Roskovec-Hoxharë (FRK-IV), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 10 136 ha dhe me ngritje mekanike me hidrovor një sipërfaqe 790 ha;

d) zona e fushës së Libofshës (FRK-V), me sipërfaqe 6180 ha, nga të cilat 3480 ha kullohen me ngritje mekanike me hidrovorin e Karavastasë;

dh) zona e fushës që kullon me kolektorin Bitaj (FRK-VI), me rrjedhje të lirë në një sipërfaqe 2870 ha;

e) zona e fushës së luginës së lumit Gjanicë (FRK-VII), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 591 ha;

ë) zona e fushës së luginës së lumit Seman (FRK-VIII), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 184 ha;

f) zona e fushës Kute-Çorrush (MKK-1,2), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 771 ha;

g) zona e fushës Hekal-Romes (MKK-3,4), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 300 ha;

gj) zona e fushës Mollas-Damës (MKK-4,5), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 490 ha;

h) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

i) sistemi i mbrojtjes së tokave nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari, brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

